

PERKUFIZIMET E TERMEVE

3. Në grupin e tretë paraqitet fusha Kredite si person i lidhur. Varësisht së në çfarë roli është i lidhur kredimarrësi me ndonjë kredi tjetër që nuk është kredi personale paraqitet kategoria përkatëse. Kategoritë e mundshme janë: Drejtor, Garantues, Pronarë apo Bashkëpronarë, Bashkëhuamarrës.

Edhe në këtë pjesë të raportit paraqiten të gjitha të dhënat për kredinë sikurse në pjesën e dytë. Në këtë pjesë paraqitet edhe Espozimi total i përfshirë dhe rolet e lidhura, ku paraqitet shuma totale ne te gjitha rolet e lidhura te kredimarrësit ne fjale.

4. Në grupin e katert paraqitet Historia kreditore ku listohen të gjitha kreditë e likuiduara të kredimarrësit si dhe të gjitha kreditë që kanë pasur klasifikim jo të mirë gjatë historisë së pagesës. Kreditë në këtë grup figurojnë deri në 5 vite duke filluar nga data e likuidimi të kredisë.

5. Në grupin e pestë paraqitet tabela që tregon të gjitha kërkimet e bera ne 3 muaj e fundit per kredimarrësin ne fjale. Ne kete table paraqiten informata per daten, insitucioni dhe degen qe ka kryer kerkimin.

1. Në grupin e parë paraqiten shënime të përgjithshme për kredimarrësin ku përshihen të dhënat personale si Emri, Mbiemri, Nr. Personal/ Nr. i regjistrimit, Lloji i klientit, Datëlindja, Vendlindja, Gjendja martesore, Adresa Zyrtare, Profesioni dhe Te ardhurat mujore neto.

2. Në grupin e dytë paraqiten kreditë personale të kredimarrësit të grupuara sipas produktit kreditorë ku së pari paraqiten Huatë pastaj Mbitërheqjet, Kartat e kreditit e kështu me radhë. Kategoritë për të cilat kredimarrësi nuk ka të dhëna të raportuara nuk paraqiten në raport. Brenda llojeve të kredive paraqiten të dhëna si Roli, Lloji i Kredise, Klasifikimi, Shuma e aprovuar, Shuma e mbetur, Shuma e kestit, Shuma e vonuar, Data e aprovimit, Data e shpërndarjes, Data e maturimit, Data e klasifikimit të fundit, Kredi e riprogramuar si dhe Fusha per koment. Ne kete grup listohet edhe kolateralet e deklaruar te kredimarrësit me kredine per te cilen jane raportuar. Kjo fushe permbane te dhena per kolateralin si Numri serik i kolateralit, Kategoria dhe Shuma e vlerësuar.

Në këtë grup paraqitet edhe fusha Ekspozimi i bazuar ne kredite aktive qe paraqet shumen totale te kredive aktive te kredimarrësit dhe te dhëna si: Numri total i kredive, Numri i ofruesve, Shuma totale e miratuar, Shuma totale e disbur-suar, Shuma totale e kesteve mujore, Shuma totale e mbetur dhe Shuma totale e vonuar.



PËRSHKRIMI I RAPORTIT KREDITOR

për më shumë.... www.bqk-ks.org

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Adresa: Rr. Garibaldi nr.33
10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni: 038 222 055 Ext 219
regjistriikrediteve@bqk-ks.org
www.bqk-kos.org



BANKA QENDORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI KREDITOR



REGJISTRI I KREDIVE TË KOSOVËS
REGISTAR KREDITA KOSOVA
CREDIT REGISTRY OF KOSOVO

Data: 05.12.2012 Koha: 11:53

Të dhënat e klientit

Emri dhe Mbiemri i klientit	KOMPANIA	Adresa Zyrtare/ Vendi	Rr. NENA TEREZE, PRISHTINE
Nr. Personal / Regj. istrimit	70000000	Profesioni / Aktiviteti	Tregti
Lloji i klientit	Juridik	Të ardhurat mujore Neto	
Datëlindja / Regjistrimi	01.01.2001		
Vendlindja / Regjistrimi	Prishtine		

Kreditë personale

Roli	Lloji i kredisë	Data e aprovimit	Data e disbursimit	Data e maturimit	Shuma e aprovuar	Shuma e disbursuar	Shuma e kështit	Shuma e mbetur	Shuma e vonuar	Data e klasifikimit të fundit	Klasifikimi aktual	Kred. e riprogramuar	Koment
Kredimarrës	Hua	22.02.2012	23.02.2012	23.09.2016	10,000.00	10,000.00	0.00	9,175.56	0.00	31.08.2012	A		x

Klasifikimi	2012
	AAAAAAA

Ekspozimi i bazuar në kreditë aktive

Numri total i kredive aktive	Numri i institucioneve	Shuma totale e miratuar	Shuma totale e disbursuar	Shuma totale e kësteve mujore	Shuma totale e mbetur	Shuma totale e vonuar
1	1	10,000.00	10,000.00	0.00	9,175.56	0.00

Kreditë si person i lidhur

Roli	Lloji i kredisë	Data e aprovimit	Data e disbursimit	Data e maturimit	Shuma e aprovuar	Shuma e disbursuar	Shuma e kështit	Shuma e mbetur	Shuma e vonuar	Data e klasifikimit të fundit	Klasifikimi aktual	Kred. e riprogramuar	Koment
Garantor	Hua	24.07.2012	31.07.2012	15.07.2014	300,000.00	0.00	0.00	300,000.00	0.00	31.07.2012	C		o

Të gjitha kërkimet për 3 muajt e fundit

Data e kryerjes së kërimit	Institucioni që ka kryer kërkimin	Dega e Institucionit prej nga është kryer kërkitimi
30.10.2012	Banka 1	Prishtinë
31.10.2012	Banka 2	Dega Qendër, Prishtinë

Klasifikimi i kredisë bëhet çdo muaj. Tabela në vijim paraqet kategoritë varësisht prej ditëve të vonesës së kthimit të kështit por edhe faktorë tjerë të konsideruar nga institucionet kredidhënëse :

Kategoria	Titulli	Pershkrimi
A	Standard	Kredimarrësi është i rregullt ose ka vonesa deri në 30 ditë në kthimin e kështit
B	Vrojtes	Kredimarrësi ka vonesa prej 31 deri në 60 ditë gjatë kthimit të kështit
C	Nënstandard	Kredimarrësi ka vonesa prej 61 deri në 90 ditë gjatë kthimit të kështit
D	Dyshimtë	Kredimarrësi ka vonesa prej 91 deri në 180 ditë gjatë kthimit të kështit
E	Humbur	Kredimarrësi nuk ka kthyer kështin e kredisë në periudhë më shumë se 180 ditë
L	Likuiduar	Kredia është e përfunduar (likuiduar) dhe kredimarrësi i ka kthyer të gjitha kështet
W	Write-off	Kredimarrësi nuk e ka kthyer kredinë. Ky është klasifikimi më i keq i mundshëm

Në qoftëse forma e klasifikimit paraqitet sikurse shembulli në tabelen e mëposhtme, rreshti i pare paraqet vitin ndërsa secila shkronje paraqet kategorinë e klasifikimit të një muaji prej muajve të atij viti, dhe fillon nga muaji i fundit i pagesës së kështit:

Viti	2012	2011	2010
Klasifikimi	AAAABABAAACA	AAAAAAAAAABA	AAAABA

Viti 2012 në shembullin më lartë ka dymbëdhjetë shkronja, secila nga këto shkronja paraqet kategorinë e klasifikimit në muajin e caktuar. Shkronjat fillojnë nga pagesa e fundit e kredimarrësit.

Kategoritë e klasifikimit për 12 muajt e vitit 2012 të zbërthyer:

Viti	2012											
Muaji	Dhjetor	Nëntor	Tetor	Shtator	Gusht	Korrik	Qershor	Maj	Prill	Mars	Shkurt	Janar
Klasifikimi	A	A	A	A	B	A	B	A	A	A	C	A

Përgjegjësi për të dhënat e prezantuara në këtë raport i përket institucionit kredidhënës i cili i ka raportuar ato në sistemin e CRK-së. Odgovornost o podacima prikazanim na ovome izveštaju snosi institucija davoac kredita koja ih je unela u sistem CRK. Responsibility for the data shown on this report belongs to the credit providing institution that reported them in the CRK system.